

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E KURRIKULAVE, CILËSISË DHE STATISTIKAVE

Nr. 1659 prot.

Durrës, më 04/04 /2025

Lënda : Raport mbi pyetësin e vlerësimit nga studentët e Doktoraturës për programet e Ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë", që ofrohen pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës.



Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi, Rektor
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës

I nderuar Z. Rektor,

Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së arsimit të lartë dhe për të vlerësuar në mënyrë empirike përvojën e studentëve të ciklit të tretë të studimeve, "Doktoratë" që ofrohen pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, Sektori i Sigurimit të Cilësisë në Drejtorinë e Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave, ndërmori një anketim të strukturuar me studentët e doktoratës. Pyetësi synonte të mbledhë të dhëna mbi cilësinë e organizimit akademik, aksesin në burime shkencore dhe teknologjike, mbështetjen institucionale dhe përgatitjen për karrierën kërkimore e akademike. Anketa është realizuar, në Google Forms, me pjesëmarrjen e 29 studentëve nga programe të ndryshme "Doktoratë", duke ofruar një pasqyrë përfaqësuese të situatës aktuale.

Programi, Viti dhe Forma e Studimeve

- 51.7% e studentëve janë të regjistruar në programin e Shkencave Ekonomike, 27.6% në programin e së Drejtës Publike dhe 20.7% në Shkencat e Edukimit.
- 51.7% ndodhen në vitin e tretë të studimeve, 27.6% në vitin e parë dhe 20.7% në vitin e dytë.
- 72.4% ndjekin doktoraturën me kohë të pjesshme dhe 27.6% me kohë të plotë.



Organizimi dhe Cilësia e Programit

- 72.4% e studentëve e vlerësuan organizimin e programit si shumë të kënaqshëm, 20.7% si mjaft të kënaqshëm.
- 41.4% e vlerësuan cilësinë e kurseve dhe trajnimeve si shumë të lartë dhe 37.9% si të lartë.
- 86.2% kanë qasje të mjaftueshme në literaturë shkencore dhe baza të dhënash.

Mbështetja Akademike

- 96.6% e studentëve kanë një udhëheqës të caktuar për tezën.
- 85.7% e vlerësojnë mbështetjen nga udhëheqësi si shumë të kënaqshme.
- Takimet zhvillohen çdo muaj për 62.1% të studentëve dhe çdo javë për 24.1%.
- 100% kanë marrë udhëzime të qarta për metodologjinë dhe shkrimin akademik.

Vlerësimi nga Komisionet

- 93.1% e konsiderojnë procesin e monitorimit nga komisioni si transparent dhe të drejtë.
- 32.1% kanë marrë udhëzime të qarta dhe të dobishme nga komisioni, ndërsa 39.3% nuk kanë marrë udhëzime konkrete.

Infrastrukturë dhe Mbështetje

- 89.7% e studentëve konfirmuan akses në laboratorë, biblioteka dhe ambiente kërkimore.
- 92.9% janë të kënaqur me mbështetjen teknologjike dhe IT.
- 89.7% kanë pasur mundësi të prezantojnë punën në seminare dhe konferenca.

Publikime dhe Mobilitet

- 44.8% kanë publikuar në revista ndërkombëtare, 34.5% në revista lokale ose kombëtare.
- 50% kanë përfutur nga mobiliteti akademik (Erasmus+, vizita studimore).

Përgatitja për Tregun e Punës

100% e të anketuarve shprehen se ndihen të përgatitur për sfidat profesionale dhe akademike pas përfundimit të doktoratës.

Programet e Përbashkëta Ndërkombëtare

- 68.8% bashkëpunojnë me Universitetin Tor Vergata në Itali, 31.3% me Universitetin Pedagogjik të Krakovit.
- 83.3% raportojnë mbështetje më të madhe nga UAMD.
- 58.8% e vlerësuan përvojën si shumë pozitive dhe 35.3% si pozitive.

Analizë Përfundimtare dhe Rekomandime Strategjike

Të dhënat tregojnë për një nivel të kënaqshëm të organizimit akademik, mbështetjes institucionale dhe përfshirjes në veprimtari kërkimore. Identifikohen gjithashtu disa fusha që kërkojnë përmirësim:

- Rritja e mobilitetit ndërkombëtar.
- Balancimi i mbështetjes mes institucioneve partnere.
- Zgjerimi i trajnimeve të avancuara kërkimore.

Rekomandohet që universiteti të zhvillojë politika për mbështetje të integruar akademike, të forcojë bashkëpunimet ndërkombëtare dhe të investojë në kapacitetet kërkimore të studentëve të doktoratës.

Nga analiza e të dhënave rezulton se Universiteti "Aleksandër Moisiu" ka ndërtuar një strukturë funksionale të programeve të ciklit të tretë "Doktoratë" që siguron cilësi, mbështetje akademike dhe akses në burime të rëndësishme kërkimore. Studentët shprehen të kënaqur me përgatitjen metodologjike dhe komunikimin me udhëheqësit akademikë.

Gjithashtu, pjesa më e madhe e tyre janë të angazhuar në publikime shkencore dhe ndihen të përgatitur për tregun profesional pas diplomimit. Megjithatë, disa problematika mbeten prezente:

1. Nevoja për rritjen e pjesëmarrjes në mobilitete akademike dhe trajnime ndërkombëtare.
2. Baraspeshimi i mbështetjes mes UAMD dhe institucioneve të huaja.
3. Zgjerimi i numrit të aktiviteteve publike për prezantimin e kërkimeve shkencore.
4. Rritja e aksesit në trajnime praktike të avancuara për zhvillimin e kapaciteteve kërkimore.

Rekomandojmë:


1. Hartimin e një metodologjie të unifikuar për mbështetjen e studentëve të doktoratës në të dy universitetet.
2. Krijimi i një platforme digjitale për ndarjen e informacionit dhe trajnimeve mes universiteteve partnere.
3. Monitorimi sistematik i ecures së kërkimit, publikimeve dhe karrierës akademike.
4. Përfshirja e studentëve të doktoratës në projekte kërkimore të financuara dhe rrjete shkencore ndërkombëtare.

Duke ju Falenderuar për mirëkuptimin,

**DREJTORIA E KURRIKULAVE, CILËSISË
DHE STATISTIKAVE**

Dr. Spiro Paço





PYETËSOR PËR STUDENTËT E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE, DOKTORATË, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS


29 responses

[Publish analytics](#)

 Copy

Në cilin program të doktoratës jeni të regjistruar?

29 responses




- "E Drejtë Publike" - Fakulteti i Shkencave Politike Juridike
- "Shkenca Ekonomike" - Fakulteti i Biznesit
- "Shkenca Edukimi" - Fakulteti i Edukimit

Në cilin vit të studimeve të doktoratës jeni aktualisht?

 Copy


29 responses



Forma e studimeve

 Copy

29 responses




ORGANIZIMI DHE CILËSIA E PROGRAMIT




Si e vlerësoni strukturën dhe organizimin e programit tuaj të doktoratës?

29 responses



A keni qasje të mjaftueshme në literaturën shkencore dhe bazat e të dhënave akademike?


29 responses






Si e vlerësoni cilësinë e leksioneve; kurseve; trajnimeve; workshopeve në doktoratë?

29 responses



A ka mundësi të mjaftueshme për trajnime dhe zhvillim profesional për doktorantët?

29 responses




SUPERVIZIMI AKADEMIK




A keni një udhëheqës akademik të caktuar për tezën tuaj? Copy


29 responses

**Si e vlerësoni mbështetjen që merrni nga udhëheqësi juaj akademik?** Copy

28 responses

**Sa shpesh takoheni me udhëheqësin tuaj akademik për të diskutuar mbi progresin tuaj?** Copy


29 responses



A merrni udhëzime të qarta dhe të strukturuar për metodologjinë e kërkimit dhe shkrimin akademik?

 Copy

29 responses




Po
Jo

A e konsideroni procesin e vlerësimit periodik të ecurisë së programit tuaj individual të doktoratës nga Komisioni si transparent dhe të drejtë?

 Copy

29 responses




Po, plotësisht
Po, pjesërisht
Jo, ka nevojë për përmirësime
Jo, është i paqartë dhe joefektiv



A merrni udhëzime dhe rekomandime të qarta nga Komisioni për Vlerësimin Periodik të Ecurisë së Programit Individual të Doktoratës, të cilat ju ndihmojnë në përparimin akademik dhe kërkimor?

28 responses




- Po, rekomandimet janë të dobishme dhe të qarta
- Po, por jo gjithmonë janë të zbatueshme
- Jo, rekomandimet janë të përgjithshme dhe jo shumë të dobishme
- Nuk kam marrë ndonjë rekomandim konkret

INFRASTRUKTURA DHE BURIMET



A keni akses në laboratorë, biblioteka dhe ambiente kërkimore?

29 responses




- Po
- Jo

A është infrastruktura teknologjike dhe mbështetja IT e përshtatshme për nevojat tuaja kërkimore?

 Copy


28 responses



A janë organizuar konferenca ose seminare të mjaftueshme për të ndihmuar doktorantët të prezantojnë punën e tyre?

 Copy


29 responses



PËRGATITJA PROFESIONALE DHE PUBLIKIMET

A keni publikuar punime shkencore gjatë periudhës së doktoratës? Copy


29 responses



- Po, në revista të indeksuara ndërkombëtare
- Po, në revista lokale ose kombëtare
- Jo, ende jo

A keni pasur mundësi për mobilitet akademik (Erasmus+, konferenca jashtë vendit, vizita studimore)? Copy

28 responses



- Po
- Jo

A ndiheni të përgatitur për tregun akademik dhe profesional pas përfundimit të doktoratës? Copy

29 responses




- Po
- Jo

PYETJE PËR STUDENTËT E DOKTORATAVE TË PËRBASHKËTA ME UNIVERSITETE TË TJERA

Cili është institucioni i huaj me të cilin bashkëpunon programi juaj i doktoratës?

16 responses




- Universiteti Tor Vergata, Romë, Itali
- Universiteti Pedagogjik i Krakovit, Krakov, Poloni



A keni marrë mbështetje të mjaftueshme nga të dy universitetet në procesin e mbikëqyrjes së doktoratës suaj?

18 responses




- Po, nga të dyja universitetet
- Po, por më shumë nga UAMD
- Po, por më shumë nga universiteti partner
- Jo, mbështetja ka qenë e pamjaftueshme

Si e vlerësoni përvojën tuaj në programin e përbashkët të doktoratës?



17 responses



- Shumë pozitive
- Pozitive
- Mesatare
- Negative
- Shumë negative

Ju falënderojmë për kohën tuaj dhe kontributin në përmirësimin e programeve të Ciklit të Tretë të Studimeve, doktoratë, në UAMD!

This content is neither created nor endorsed by Google. - [Contact form owner](#) - [Terms of Service](#) - [Privacy Policy](#)

Does this form look suspicious? [Report](#)

Google Forms